



Universiteti Bujqësor i Tiranës



Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore
Shkodër



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

ndërmjet

UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS

dhe

QENDRËS SË TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE SHKODËR

Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Universitetit Bujqësor të Tiranës, (UBT) me adresë Kodër-Kamëz, Tiranë, i përfaqësuar për lidhjen e kësaj Marrëveshjeje nga Rektori i UBT, **Prof. Dr. Fatbardh Sallaku**

dhe

Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore Shkodër", (QTTB Shkodër), me seli në adresën Rruga Nacionale Shkodër - Hani i Hotit, km 1, Dobraq, Shkodër përfaqësuar nga Drejtori **Dr. Naim Laçe**.

Palët e mësipërme bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Palët shprehin gadishmërinë që të bashkëpunojnë për aplikimin e projektit me titull "Studimi i bimëve që përmbajnë Alkaloidet Piroлизidine (PA) bashkëshoqeruese të Bimëve Aromatike dhe Mjekësore (BAM) të kultivuara dhe mundësitë për kontrollin e cilësisë për BAM në Malësinë e Madhe" pranë Agjensisë Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit

Neni 2

Palët shprehen të gatshme të asistojnë njëra-tjetrën, sipas specifikave dhe detyrave të përcaktuara në kuadër të projektit dhe në respekt të politikave, procedurave dhe

standardeve teknike, etike, mjedisore, shëndetësore e ligjore që garantojnë mbarëvajtjen e zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta për qëllime studimore dhe shkencore.

Neni 3

Palët njohin paraprakisht se kjo Marrëveshje përbën një dokument sipas të cilit palët deklarojnë paraprakisht vullnetin e tyre të lirë për një bashkëpunim në realizimin e projektit.

Neni 4

Kjo marrëveshje lidhet për gjithë kohëzgjatjen e projektit.

Për:

Qendrën e Transferimit të Teknologjive
Bujqësore Shkodër

Drejtori



Dr. Naim Laçe

Datë: __/__/2024

Për:

Universitetin Bujqësor të Tiranës

Rektori



Prof. Dr. Fatbardh Sallaku

Datë: 08/23/2024